

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6870
E shtunë, 8 prill 2023
çmimi 0.40 €

Propozimet për reformën
zgjedhore përcillen
për në Kuvend FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

EKSPERTËT NDËRKOMBËTARË: E VËSHTIRË TË SHPALLEN FAJTORË ISH-KRERËT E UÇK-së

FAQE 4-5



Prokurorët e specializuar në Hagë do ta kenë të vështirë të dëshmojnë se ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë përgjegjës për krimet e supozuara, thonë ekspertët e drejtësisë tranzicionale, Mathias Holvoet dhe Aidan Hehir

15-VJETORI I
KUSHTETUTËS,
PRESIDENTJA
OSMANI:
KUSHTETUTA
JONË ËSHTË
TEJET UNIKE

FAQE 3



ARSIMI DHE AFTËSIMI
PROFESIONAL,
AVOKATI I POPULLIT:
NUK JANË NË
PËRPTHJE ME
KËRKESAT E
TREGUT TË PUNËS

FAQE 6



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



SHEFJA E FMN-së: RRRITJA
EKONOMIKE DO TË JETË E
NGADALSHME JASHTË INDISË
DHE KINËS F. 2

KFOS-i LANSON "PANELET
DIELLORE NË SHKOLLA"
TË PRISHTINËS F. 6

REAGIM I KMDLNJ-së: GJYKATA
SPECIALE NUK MUND TA
DETYROJË QEVERINË E KOSOVËS
T'I KOMPENSOJË VIKTIMAT F. 5

EKONOMI



KURTI: DO T'I MBËSHETIM QYTETARËT
QË SHPENZOJNË DERI NË 800
KILOVATË ENERGJI ELEKTRIKE F. 8

ODA EKONOMIKE ORGANIZON
TAKIM TË PËRBASHKËT KOSOVË -
SHQIPËRI, DISKUTOHET PËR
ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE
NË PORTIN E DURRËSIT F. 8

SPORT



DRITA KËRKON TRI PIKË NDAJ
TREPÇËS '89 F. 14

Shefja e FMN-së: Rritja ekonomike do të jetë e ngadalshme jashtë Indisë dhe Kinës

UASHINGTON, 7 PRILL - Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) pret vetëm rritje të ngadalshme ekonomike në vitet në vijim pavarësisht prej tregjeve të punës, ka thënë shefja e kësaj organizate, Kristalina Georgieva. "Rritja vazhdon të jetë e ngadalshme, në nivele historike tani dhe në periudhë afatmesme", ka thënë Georgieva, duke shtuar se India dhe Kina kanë kontribuar në gjysmën e rritjes ekonomike globale këtë vit.

Rritja është duke u ngadalësuar në 90 për qind të shteteve të industrializuara, përfshirë Eurozonën ku, sipas FMN-së, normat e larta të interesit do të rëndojnë mbi kërkesën. FMN-ja do të paraqesë gjetjet e reja javën e ardhshme, në takimin pranveror në Uashington. Në janar kjo organizatë pati parashikuar rritje ekonomike globale vetëm 2.9 për qind për këtë vit për shkak të pasojave të shkaktuara nga lufta në

Ukrainë dhe inflacionit të lartë. Mirëpo tani pamja është edhe më e "zbehtë" sesa në tetor, ka thënë FMN-ja. "Duke marrë parasysh tensionet gjeopolitike në rritje dhe inflacionin ende të lartë, rimëkëmbja e fuqishme është pak e mundshme", ka theksuar Georgieva, e cila i ka përgëzuar bankat qendrore për politikatat e tyre strikte monetare. Sipas saj, bankat duhet të vazhdojnë të luftojnë kundër inflacionit të lartë.



Lituanian do të kërkojë që Ukrainës t'i jepet ftesa për anëtarësim në NATO në korrik



VILNIUS, 7 PRILL - Parlamenti lituanëz ka miratuar një rezolutë e cila propozon që Ukrainës t'i jepet ftesa për anëtarësim në NATO gjatë samitit të aleancës që do të mbahet në korrik në këtë shtet.

Nga 141 deputetë të parlamentit, 129 morën pjesë në votim dhe të gjithë votuan pro rezolutës. "Ne besojmë se Ukraina do të kontribuojë në sigurinë tonë dhe do ta bëjë

NATO-n më të fortë", tha kryetari i Komitetit për Punë të Jashtme, Zygimantas Pavilionis.

Samiti i ardhshëm i NATO-s është planifikuar të mbahet më 11-12 korrik në kryeqytetin e Lituanisë, Vilnius.

Në shkurt Ukraina tha se shpreson ta marrë ftesën për anëtarësim në NATO në fillim të kësaj vere.

Më 30 shtator të vitit të kaluar Ukraina ka dorëzuar kërkesën

për aplikim për anëtarësim në NATO përmes procedurës së përsheptuar.

Në ditën e aplikimit, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, kur u pyet për ofertën e Ukrainës në NATO, tha se "çdo demokraci në Evropë ka të drejtë të aplikojë për anëtarësim në NATO dhe aleatët e NATO-s e respektojnë këtë të drejtë. Dhe, ne kemi deklaruar vazhdimisht se dera e NATO-s mbetet e hapur".

Prokurorët rusë kërkojnë 25 vjet dënim për kritikun e Kremlinit



MOSKË, 7 PRILL - Prokurorët kanë kërkuar dënim me 25 vjet burgim për kritikun e Kremlinit, Vladimir Kara-Murza, tha avokatja e tij.

Avokatja Maria Eismont u tha gazetarëve se kërkesa e prokurorit për dënimin 25-vjeçar erdhi në një seancë të mbyllur më 6 prill. Ajo shtoi se klienti i saj ka humbur 17 kilogramë gjatë qëndrimit në burg. Ajo tha se çështja kundër aktivistit të opozitës ruse për

disa akuza, përfshirë tradhtinë, po vazhdon me shpejtësi.

Kara-Murza u arrestua në prill të vitit të kaluar, pasi u kthye në Rusi.

Vladimir Kara-Murza, ish-aleat politik i liderit të ndier opozitar rus, Boris Nemstov, pasi humbi vetëdijen dhe u dërgua në spitalin e Moskës, gruaja e tij tha se ai u dërgua në spital me "simptomat e helmimit".

Sikurse në rastet paraprake, Rusia ka mohuar përfshirjen,

duke përmendur mungesën e fakteve.

Kara-Murza beson se të dyja incidentet kanë qenë hakmarrje për aktivizmin e tij politik, duke përfshirë lobimin e tij për Aktin amerikan Magnitsky.

Ky ligj i vitit 2012 parasheh vendosjen e sanksioneve ndaj rusëve për të cilët beson se abuzojnë me të drejtat e njeriut.

Ky ligj atëbotë pati zemëruar Kremlinin.

Kryeministri polak thotë se anëtarësimi i shpejtë i Moldavisë në BE është i mundur

VARSHAVË, 7 PRILL - Pranimi i shpejtë i Moldavisë në Bashkimin Evropian është i mundur, tha kryeministri i Polonisë, Mateusz Morawiecki, më 6 prill, pas takimit që pati me homologun e tij moldav, Dorin Recean. Kishinau kërkon të bashkohet me bllokun mes frikës se mund të tërhiqet në konfliktin në Ukrainën fqinje. Në korrik të vitit 2022 Moldavia, së bashku me Ukrainën, morën statusin e vendit kandidat për në BE,

vendim që nxiti zemërim në Moskë. Moldavia është e vendosur mes shtetit anëtar të Bashkimit Evropian dhe NATO-s, Rumanisë, dhe Ukrainës, me të cilën ndan një kufi prej 1 222 kilometrash. Rusia ka rreth 1 100 trupa në depot e armëve sovjetike që gjenden në rajonin e Transnjestërit në Moldavi. Në shkurt - kohën kur u rritën shqetësimet se Moldavia mund të jetë shënjestra e radhës e Rusisë pas Ukrainës -

presidenti amerikan Joe Biden "riafirmoi mbështetjen e fuqishme të SHBA-së për sovranitetin dhe integritetin territorial të Moldavisë". Më 10 shkurt Rusia lëshoi një raketë që kaloi përmes hapësirës ajrore të Moldavisë dhe përfundoi në Ukrainë. Pas këtij incidenti, Moldavia thirri në bisedë informative ambasadorin rus. Rajoni Transnjestër, që banohet kryesisht me banorë rusishtfolës, ka shpallur pavarësinë nga Moldavia më



1990, teksa Moldavia ka shprehur frikën se ky rajon do të kërkojë të bashkohet me

Rumaninë, shtet me të cilin ndan historinë dhe gjuhën e njëjtë.

15-vjetori i Kushtetutës, presidentja Osmani: Kushtetuta jonë është tejet unike

Presidentja Vjosa Osmani ka marrë pjesë të premtën në konferencën “Analizë gjithëpërfshirëse e Kushtetutës së Kosovës” të organizuar nga Grupi për Ballkan (BPRG) me rastin e 15-vjetorit të Kushtetutës së Kosovës. Ajo ka theksuar se Kushtetuta jonë është tejet unike. “Jemi ndër vendet e pakta, nëse jo të vetmet, që kanë një nivel të këtyllë të garantimit të të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, por edhe të qytetarëve në përgjithësi”, ka thënë Osmani

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 7 PRILL - Përfaqësues të institucioneve të vendit, ambasadorë të vendeve të huaja, përfaqësues të Gjykatës Kushtetuese, profesorë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, morën pjesë të premtën në konferencën “Analizë gjithëpërfshirëse e Kushtetutës së Kosovës” të organizuar nga Grupi për Ballkan (BPRG) me rastin e 15-vjetorit të Kushtetutës së Kosovës.

Presidentja Vjosa Osmani në fjalën e saj ka theksuar se në 15-vjetorin e Kushtetutës sonë, përveç urimeve më të mira për të gjithë ata që ndihmuan në hartimin e Kushtetutës, por edhe zbatimin e çdoditshëm të saj, na duhet edhe të reflektojmë mbi atë se a përbën kjo Kushtetutë bazë të mirë për ecjen tutje të vendit tonë dhe mbi atë se si ta maksimalizojmë funksionalitetin e saj për nevojat e shoqërisë sonë sot. “Nën këtë reflektim është e rëndësishme që së pari të ritheksojmë rëndësinë e nivelit më të lartë të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive që garanton

kjo Kushtetutë. Me shumë krenari e them gjithmonë se jemi ndër vendet e pakta, nëse jo të vetmet, që kanë një nivel të këtyllë të garantimit të të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, por edhe të qytetarëve në përgjithësi. Këto të drejta dhe liri janë thelbi i vlerave tona shoqërore dhe, si të tilla, duhet të mbesin të paprekura nga kushdo”, ka thënë Osmani.

Ajo ka thënë se është po kaq e rëndësishme të ritheksohet fakti se këto të drejta nuk kanë mbetur vetëm deklarative e të shkruara në Kushtetutë, por vërehet qartë se institucionet tona përpiqen çdo ditë t'i zbatojnë ato e qytetarët luftojnë për to çdo ditë. “Një armë shumë e fortë e Kushtetutës sonë është gjithashtu korniza institucionale që ajo parasheh si dhe parakushtin kryesor që ajo kornizë e ka që të funksionojë si duhet: ndarja e pushteteve si dhe baraspesha midis tyre. Është pikërisht kjo ndarje e pushteteve dhe baraspesha midis tyre ajo që do të sigurojë që vendi ynë të ecë përpara duke e mundur zbatimin edhe të pjesëve të tjera të Kushtetutës, duke u nisur nga



Kapitulli II mbi të drejtat dhe liritë e qytetarëve tanë. Janë pikërisht këto institucione ato të cilat duhet të vihen në lëvizje vetë për të siguruar se çdo shkronjë e kësaj Kushtetute respektohet edhe atëherë kur duhet ta korrigjojë praktikën e njëri-tjetrit”, ka deklaruar Osmani.

Ajo ka thënë se Kushtetuta jonë është tejet unike. “Gjatë këtyre 15 vjetëve Kushtetua jonë ka pësuar shumë ndryshime, veçanërisht në kuadër të obligimeve ndërkombëtare të vendit tonë, në kornizën institucionale, si dhe mënyrën se si ato kanë ndërvepruar në të kaluarën. Kemi nisur historinë e saj me institucione ndërkombëtare që mbikëqyrnin pavarësinë e institucioneve tona e të cilat u larguan me vendim të

vendit tonë”, është shprehur Osmani.

Në këtë konferencë kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, tha se kushtetutshmëria e Kosovës është ende në formësim e sipër. Sipas tij, Kosova ishte projekt ndërkombëtar dhe vendës. Sipas Konjufcës, për rregullimin e të drejtave të njeriut dhe të pakicave që ekzistojnë në Kushtetutën e Kosovës mund të marrin mësim edhe vendet e tjera.

Ai tha se tani Kosova është në një fazë të stabilitetit më të qëndrueshëm kushtetues. “Kushtetuta jonë ishte produkt i fazave nëpër të cilat kaloi Kosova. Kushtetutshmëria jonë është në formësim e sipër, sepse po flasim për një trashëgimi kushtetuese”, ka thënë ai. Konjufca ka shtuar se kur

Kushtetuta fillon të funksionojë shihet se ka probleme në ecje e, po ashtu, sipas tij, pjesë të ndryshme kanë interpretime se si duhen funksionuar. “E ndër vite ato edhe ndryshojnë falë demokracisë. Kosova shumë shpejt do të futet në një fazë të stabilitetit më të qëndrueshëm kushtetues”, ka thënë kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca.

Në këtë konferencë do të paraqitet raporti i politikave “Kushtetuta e Kosovës: Rishikim Gjithëpërfshirës & Analizë Ligjore”, që analizon 21 çështje kushtetuese që lidhen me sistemin e ligjeve, funksionimin e institucioneve dhe juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese si dhe propozon zgjidhje për mangësitë kushtetuese.

Propozimet për reformën zgjedhore përcillen për në Kuvend

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 7 PRILL - Kryetari i Komisionit Ad Hoc të Kuvendit për Reformën Zgjedhore, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se ky komision ka përmbyllur punën duke përfunduar të gjitha propozimet që do t'i shkojnë Kuvendit për miratim. “Pas një angazhimi sistematik për muaj me radhë, duke iu përgjigjur një klime të debatit tematik e gjithëpërfshirës rreth reformave, kemi ndërtuar një konsensus normativ që sistemin zgjedhor të Kosovës e avancoi në një dimension të ri, duke iu përgjigjur kërkesës për transparencë, demokraci e besim, paralelisht me aderimin në standardet ndërkombëtare e demokratike bashkëkohore”, ka thënë ai.

Tahiri ka thënë se është shumë mirënjohës ndaj të gjitha grupeve

parlamentare për konstruktivitetin dhe kohezionin e plotë me të cilin iu kanë qasur reformave si rezultat i të cilit kanë arritur ta përmbyllin një proces vital për demokracinë në vendin tonë. “Shpresoj shumë që edhe Kuvendi do t'i trajtojë e formalizojë së shpejti propozimet e reformës zgjedhore si një hap drejt fuqizimit të demokracisë dhe rritjes së sigurisë e cilësisë së proceseve zgjedhore demokratike”, ka thënë Tahiri.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka mirëpritur përmbylljen me sukses të propozimeve legislative për realizimin e kësaj reforme dhe ka përgëzuar anëtarët e Komisionit Ad Hoc të Kuvendit për Reformën Zgjedhore, të kryesuar nga shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, për punën e madhe, kohezionin politik e



përkushtimin përtej partiak për të avancuar këtë segment vital të demokracisë.

Krasniqi ka thënë se për më shumë se një dekadë PDK-ja ka qenë e hapur dhe e angazhuar për ta reformuar sistemin

zgjedhor në Kosovë me qëllim të avancimit strukturor dhe përmbytjesor të proceseve elektorale si një parakusht për demokraci të qëndrueshme, pushtete të përgjegjshme dhe institucione të ligjshme. “Kjo

reformë tashmë është në procedura parlamentare dhe së shpejti do të miratohet për t'i dhënë vullë përfundimisht vullnetit politik konsensual që e kemi arritur”, ka shkruar Krasniqi në “Facebook”.



Ekspertët ndërkombëtarë: E vështirë të shpallen fajtorë ish-krerët e UÇK-së

Prokurorët e specializuar në Hagë do ta kenë të vështirë të dëshmojnë se ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë përgjegjës për krimet e supozuara, thonë ekspertët e drejtësisë tranzicionale, Mathias Holvoet dhe Aidan Hehir

Prishtinë, 7 prill - Prokurorët e specializuar në Hagë do ta kenë të vështirë ta dëshmojnë se ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë fajtorë për krimet e supozuara, thonë për "Radion Evropa e Lirë" dy ekspertë të drejtësisë tranzicionale, Mathias Holvoet dhe Aidan Hehir. Holvoet, ligjërues i së Drejtës Penale Ndërkombëtare në Universitetin e Amsterdemit në Holandë, thotë se atij i ka bërë përshtypje edhe se sa i fuqishëm është ekipi i mbrojtjes i të akuzuarve. "Problemi është gjithmonë në gjetjen e lidhjes mes krimeve të kryera fizikisht në terren dhe njerëzve më të fuqishëm në organizatë, si [Hashim] Thaçi, [Kadri] Veseli, [Rexhep] Selimi dhe [Jakup] Krasniqi. Dhe, këtë do të duhet ta dëshmojë Prokuroria dhe do të jetë e vështirë. Për të qenë i sinqertë, instinkti më thotë se mund fare mirë të ketë shpallje

pafajësi", thotë Holvoet, duke shtuar se mund të ketë dallime mes katër të akuzuarve. Si shembull që tregon se sa e vështirë është që një lidhje e tillë të dëshmohet, Holvoet u referohet aktgjyqimeve të Tribunalit të Hagës në rastet ndaj ish-eporëve të UÇK-së, Ramush Haradinaj dhe Fatmir Limaj, të cilët u shpallën të pafajshëm lidhur me akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Pas më shumë se dy vjet nga konfirmimi i aktakuzës, gjyqi ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit nisi të hënën, më 3 prill, në Gjykatën Speciale në Hagë. Ata akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Gjatë deklaratave hyrëse, Prokuroria argumentoi se të akuzuarit dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së kanë qenë pjesë e një "ndërmarrjeje të

përbashkët kriminale" që shënjestronte ata që i konsideronte "kolaboracionistë" dhe "tradhtarë" për të "fituar pushtet". Ndërsa avokatët hodhën poshtë të gjitha akuzat që rëndojnë ndaj klientëve të tyre, duke argumentuar se UÇK-ja nuk kishte një strukturë komande efikase. Për Holvoet dhe Hehir, studiues i drejtësisë tranzicionale, intervenimit humanitar dhe shtetndërtimit në Kosovë nga Universiteti Westminster në Angli, ajo që bie më së shumti në sy është përdorimi i termit "ndërmarrje e përbashkët kriminale". "Kushdo që është në dijeni për atë që ka ndodhur në Kosovë nuk do të habitet që ka pretendime se anëtarë të UÇK-së kanë kryer krime. Por, kjo gjykatë duket se po e akuzon UÇK-në në tërësi për një lloj strategjie të madhe, që mendoj se është e paqëndrueshme. Ideja që UÇK-ja të jetë një ndërmarrje kriminale... ky term është shumë nënçmues dhe mendoj se kjo do t'i alarmojë njerëzit [në Kosovë] dhe do ta prekë me të vërtetë atë nerv që njerëzit ndiejnë në lidhje me UÇK-në si heronj", shton ai.

Gjatë deklaratave hyrëse, prokurori i Specializuar, Alex Whiting, tha se rasti ndaj ish-katër krerëve të UÇK-së ka të bëjë vetëm me ta e jo me gjithë UÇK-në, duke shtuar se "shumica e anëtarëve të UÇK-së nuk kishin të bënin fare me krimet për të cilat është ngritur aktakuza". Ndërsa në ditën e fundit të deklaratave hyrëse, më 5 prill, ish-zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi, tha se deklaratat e tij të asaj kohe - të cilat u përdorën nga prokurorët si dëshmi - ishin vetëm propagandë për ta krijuar "përshtypjen se UÇK-ja ishte strukturë e organizuar". Megjithatë, Holvoet vë në dukje se në Tribunalin e Hagës ka pasur dënime edhe për përhapje të propagandës. Milan Gvero, ndihmëskomandant në ushtrinë serbe të Bosnjës, ishte dënuar në vitin 2010 me pesë vjet burgim për shpërndarje të informatave të rreme. Sipas gjyqimit të Tribunalit të Hagës, përmes informatave të rreme ai kishte kontribuar në ndërmarrjen e përbashkët kriminale që synonte ta pastronte etnikisht zonën e Srebrenicës në Bosnjë

dhe Hercegovinë. Sipas Hehir, procesi gjyqësor ndaj ish-krerëve të UÇK-së do të jetë nën hijen e protestave që u zhvilluan në Hagë dhe në Prishtinë para nisjes së këtij procesi. Kjo veçanërisht pasi që ai pret që procesi të jetë i ngadaltë. "Unë mendoj se do të jetë një proces i ngadaltë i zbulimit të informacionit për tre, katër, pesë, ndoshta edhe gjashtë vjet", shton ai, duke u shprehur i zhgënjyer me kohëzgjatjen e këtij procesi. Por, Holvoet argumenton se edhe pse procesi duket se do të zgjasë shumë, ai duhet të jetë i tillë në mënyrë që edhe avokatët e të akuzuarve të kenë mundësi të kundërgargumentojnë. "Është e pashmangshme. Bëhet, në njëfarë mënyrë, që të garantohet e drejta për gjykim të drejtë. Por, mendoj se problematike është që ata do të jenë në paraburgim për gjyqin pa pasur mundësi të lirohen përkohësisht", përfundon Holvoet. Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi janë në paraburgim në Hagë prej nëntorit të vitit 2020. Ata janë deklaruar të pafajshëm për akuzat e ngritura ndaj tyre.

Reagim i KMDLNj-së

Gjykata Speciale nuk mund ta detyrojë Qeverinë e Kosovës t'i kompensojë viktimat

Salih Mustafa, nga Gjykata Speciale, me një vendim të formës jo të prerë, është dënua me 26 vjet burgim për shkak të vrasjes së paligjshme, ndalimit arbitrar dhe torturës. Ndërkaq, po kjo gjykatë, të enjten, më 6 prill 2023, ka nxjerrë një vendim me të cilin e detyron ish-komandantin e UÇK-së t'ua paguaj 207 mijë euro viktimave. Me urdhrin e gjykatës për zhdëmtim u përfshinë tetë viktimat. Po sipas kësaj gjykate është konstatuar se aktualisht Salih Mustafa nuk i zotëron mjetet për të bërë këtë pagesë prandaj pritet përcaktimi i një autoriteti mbikëqyrës në lidhje me zbatimin e urdhrin për zbatim të dëmshtëpërblimit i cili do të përcaktojë hollësisht mundësitë financiare të Salih Mustafës për të paguar dëmshtëpërblimin. Nëse nuk ka asnjë mundësi që Salih Mustafa të zhdëmtojë viktimat, si opsion i gjykatës i zhdëmtimit të viktimave mbetet të bëhet nga buxheti i Kosovës përmes

Ministritë së Drejtësisë. Kohë më parë Gjykata Speciale në Hagë i ishte drejtuar Ministritë së Drejtësisë me disa pyetje për të sqaruar mënyrën dhe mekanizmat që i kompensojnë viktimat duke shprehur dyshime të mëdha në gatishmërinë e institucioneve të Kosovës për kompensimin e viktimave që ua njeh këtë status kjo gjykatë, sidomos në lartësinë e shumës me të cilën do të kompensoheshin. Qartazi nuk ishin të kënaqur me përgjigjen e kësaj ministrie e cila, në përgjigjen e saj e sqaroi se në Kosovë është një Komision për Kompensim të Viktimave të Krimin por që viktimat e supozuara nuk mund të përfitojnë asnjë kompensim sipas ligjit në fuqi sepse nuk përfshihen në kategoritë përfituese sipas këtij ligji. Gjykata Speciale në Hagë vendimin për zhdëmtim të viktimave e mbështet në Ligjin nr. 04/I-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve,

Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre. Vendimi i Gjykatës Speciale në Hagë e ka bazën e gabuar ligjore sepse në këtë ligj nuk përmendet mundësia që as drejtpërdrejtë e as në mënyrë të tërthortë të bëhet zhdëmtimi i viktimave të supozuara që janë shkaktuar nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës apo kompensimi në baza mujore siç parashihet për kategoritë e tjera që trajtohen nga Ligji nr. 04 /L - 054. Aktualisht nuk ka asnjë bazë ligjore që do të zhdëmtojë apo kompensojë në baza mujore viktimat e supozuara nga UÇK-ja dhe, rrjedhimisht për këtë arsye Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Drejtësisë nuk mund të ngarkohet me detyrime që nuk janë të rregulluara me ligj. Për ta ekzekutuar vendimin e Gjykatës Speciale duhet të krijohet një bazë ligjore sikur që edhe ekspertë nga Kosova duhet të ngarkohen me përgjegjësi me

përcaktimin e shumës së zhdëmtimit. Sipas ligjeve të Kosovës ekzekutimi i zhdëmtimit duhet të bëhet përmes procesit të përmbarimit ndërsa Gjykata Speciale nuk ka përmbarues të saj në ndërkohë që nuk i beson asnjë institucion të Kosovës përfshirë këtu edhe përmbaruesit, prandaj kërkohet të formohet një autoritet mbikëqyrës për zbatim të urdhrin për dëmshtëpërblim. Gjykata Speciale që me asgjë nuk e dëshmon se është e Kosovës, nuk i përgjigjet me asgjë dhe për asgjë asnjë autoriteti të Kosovës, jotransparente deri në konspiracion për autoritetet dhe opinionin e Kosovës dhe ndërkombëtar, me një mandat të devijuar dhe të degraduar nga qëllimi për çka ishte themeluar i shndërruar në një grup përfituesish të dështuar në Kosovë dhe në vendet tjera ku kanë punuar, duke siguruar për veten e tyre përfitime marramendëse, as që kanë ndonjë interesim që ta dinamizojnë punën e tyre që të

mos i dëmtojnë të arrestuarit duke i mbajtur për vite të tëra në paraburgim dhe gjykim, përtej çdo kohe të arsyeshme, nuk mund të vendosë dhe zbatojë standarde të dyfishta, paga marramendëse që nuk i ka asnjë institucion që është pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës (këta thonë se janë pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës me seli në Hagë!!!!), kurse në anën tjetër ta ngarkojnë buxhetin e Kosovës me shpenzime marramendëse dhe të cilat është dashur të jenë barrë e Gjykatës Speciale ashtu siç janë edhe rrogat e tyre të çmendura. Këta, si çakej juridikë, me një këmbë janë në Hagë kurse me tjetrën janë në Ukrainë apo vend tjetër ku ka luftëra dhe ku shohin mundësi marramendëse përfitimi. Mos u habitni nëse nesër po kjo Gjykatë Speciale të kërkojë nga Kosova t'ua paguajë pushimet dimërore në Sent Moric dhe ato verore në Dubai. Hetuesit, prokurorët dhe gjykatësit e Dubait, prostitucion juridik!



Kurti pret në takim përfaqësuesit e Quintit, temë diskutimi dialogu Kosovë - Serbi



PRISHTINË, 7 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bashkë me zëvendëskryeministrin e parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, ka takuar ambasadorët dhe zëvendësambasadorët e vendeve të Quintit dhe përfaqësuesen e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë. Në takim u diskutua për procesin e zbatimit të Marrëveshjes Bazike me Serbinë

dhe Planin e Zbatimit të adoptuar më 18 mars ndërmjet dy shteteve. Kryeministri Kurti dhe zëvendëskryeministri Bislimi i informuan përfaqësuesit diplomatikë mbi rezultatet e takimit të fundit në Bruksel më 4 prill dhe pritjet e tij nga ky proces në javët dhe muajt në vazhdim. "Ata shprehën përkushtimin e tyre të plotë për zbatim gjithëpërfshirës dhe të

pakushtëzuar të marrëveshjes. Kërkuan që procesi i anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës dhe pranimit i aplikimit të Republikës së Kosovës në BE të procedohet me shpejtësi si dy veprime fillestare të partnerëve tanë, që do të duhej të derivojnë nga dakordimi rreth Marrëveshjes Bazike dhe aneksit të zbatimit të saj", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

KFOS-i lanson "Panelet diellore në shkolla" të Prishtinës

Projekti "Panelet diellore në shkolla në Ballkanin Perëndimor" është lansuar të premten në dy Shkollat e Ulëta të Mesme "Qamil Batalli" dhe "Iliria" në Prishtinë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 7 PRILL - Të premten u lansua projekti "Panelet diellore në shkolla në Ballkanin Perëndimor" në dy Shkollat e Ulëta të Mesme "Qamil Batalli" dhe "Iliria" në Prishtinë.

Mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur dhe realizuar në bashkëpunim me komunën e Prishtinës dhe Jaha Solar, ky projekt synon ta promovojë tranzicionin energjetik duke rritur kapacitetet prodhuese të energjisë së pastër dhe të ripërtërishtme si dhe t'u mundësojë shkollave publike t'i ulin shpenzimet në energji dhe t'i shfrytëzojnë këto mjete për nevoja të tjera.

Si rezultat i këtij projekti, dy shkolla pilot të komunës së Prishtinës, "Qamil Batalli" dhe "Iliria", kanë përfutur me instalime të paneleve solare me kapacitet prej 20.25 kW dhe 18.9 kW respektivisht, të cilat do t'u mundësojnë shkollave të kursejnë 21 për qind dhe 30 për qind në faturat e tyre të rrymës. Në terme monetare shkollat do të mund të kursejnë prej 2 200 deri në 2 500 euro në vit vetëm nga

faturat e tyre të rrymës.

Projekti synon t'i zgjerojë burimet e të ardhurave për shkollat publike, ta forcojë vetëqeverisjen dhe pronësinë e programeve sociale, ta mbështesë tranzicionin në energji të qëndrueshme, ta rrisë përfshirjen sociale në arsim dhe të krijojë shkolla miqësore me mjedisin.

Drejtori i shkollës "Qamil Batalli", Liridon Maliqi, ka falënderuar KFOS-in për investimin, komunën e Prishtinës për mundësinë që ky investim të ndodhë në shkollat në Prishtinë, specifikisht në shkollën që drejton, si dhe Jaha Solar për implementimin e projektit. Nën kryetari i komunës së Prishtinës, Alban Zogaj, ka theksuar se komuna e Prishtinës është shumë mirënjohëse për një investim të tillë, pasi kjo i ndihmon jo vetëm komunës, por edhe tërë Kosovës dhe industrisë së energjisë në vend.

Ndërsa drejtoresha ekzekutive e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur, Lura Limani, ka potencuar se ky pilot projekt është pjesë e projektit rajonal i cili është duke u zbatuar në Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Serbi, ndërsa



sivjet do të fillojë të implementohet edhe në Bosnjë-Hercegovinë.

Në përrurim ishte edhe Zanfina Kabashi nga Jaha Solar, e cila e bëri një prezantim të shkurtër të anës teknike të implementimit të projektit. Investimi është bërë tërësisht me mjete të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur,

mirëpo po të ishte bërë nga vetë komuna apo shkolla, kthimi në investim do të ishte gjashtë vjet. Pasi që në Kosovë shkollat fillore nuk menaxhojnë buxhetin dhe nuk kanë as llogari bankare, mjetet e kursyera, sipas zotimit të komunës së Prishtinës, do t'u kthehen shkollave për të kontribuar në mirëmbajtjen e

tyre apo të shtohen investimet kapitale në këto dy shkolla. Projekti është iniciativë e përbashkët e Fondacioneve për Shoqëri të Hapur në katër vende të Ballkanit - Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut dhe Serbi. Në vitin 2023 projekti do të zgjerohet për ta përfshirë edhe Bosnjë-Hercegovinë.

Lirimi i të akuzuarit, familja e Donjeta Pajazitajt thotë se do ta çojë rastin në Kushtetuese

PRISHTINË, 7 PRILL - Të enjten Gjykata Supreme e Kosovës e ka liruar Naser Pajazitajn i cili ishte i akuzuar për vrasjen e Donjeta Pajazitajt. Por, pas lirimit të Naser Pajazitajt, vëllai i Donjetës, Shkelqim Pajazitaj, ka thënë se vendimi për lirim të të akuzuarit është i papranueshëm për familjen e viktimës. "Lajmin e kemi kuptuar përmes medieve, as nuk kemi pasur njoftim nga gjykata, as nga prokuroria. Ka qenë lajm shumë i papranueshëm dhe shumë i rëndë për ne si familje. Nuk e di qysh kanë mundur të vijnë në këtë përfundim. Si kanë mundur t'i hedhin poshtë ato fakte. Veç dy fakte po t'i vlerësonte si duhet gjykata nuk do të mund të vinte te ky vendim. Po të vlerësoheshin pamjet e kamerave mirë dhe dëshmia e vajzës së tij kur ka dalë kundër tij, atëherë këto dy fakte besoj se do të kishin qenë të mjaftueshme që mos të merrej ky vendim", u shpreh Shkelqim Pajazitaj, duke thënë se Naser Pajazitaj kishte deklaruar se në ditën e vrasjes së Donjetës ai ka qenë në bjeshkë me vajzën e tij, por vajza e tij ka mohuar se ka qenë në bjeshkë me të.

Më tej, Shkelqim Pajazitaj ka thënë se do të ankohen edhe në Gjykatën Kushtetuese, megjithëse thotë se nuk kanë shumë shpresa. "Besoj se do ta çojmë rastin edhe në Gjykatën Kushtetuese, edhe pse nuk kemi shumë shpresë", u shpreh vëllai i Donjeta Pajazitajt në "Tëvël".

Rasti i vrasjes së Donjeta Pajazitajt kishte marrë epilog dy herë në Gjykatën e Pejës. Herën e parë Naser Pajazitaj ishte shpallur i pafajshëm, herën e dytë ishte dënuar me burgim të përjetshëm. Por, në të dyja rastet, aktgjykimet ishin anuluar dhe kthyer në rigjykim. Edhe Gjykata e Ferizajt e kishte dënuar me burgim të përjetshëm, por rasti ishte kthyer në rigjykim.

Kryetari i trupit gjykues i Departamentit për Krime të Rënda në Gjykatën e Ferizajt, Ibrahim Idrizi, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave, dëgjimit të palëve, të pandehur Naser Pajazitaj e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim me burgim të përjetshëm.

I pandehuri Naser Pajazitaj akuzohej se më 9 nëntor 2015, në bjeshkët e Strellcit - Komuna



Deçan - në vendin e quajtur të "Kroni i Lajthisë", duke qenë edhe më parë i dënuar për vepër penale të vrasjes së rëndë, me dashje dhe me armë të tipit të panjohur, në mënyrë dinake dhe

për motive të ulëta, ka privuar nga jeta viktimën Donjeta Pajazitaj nga po i njëjti fshat. Në atë mënyrë që derisa viktimë ditën kritike ka qenë duke shkuar në punë, në këmbë nëpër rrugën

në drejtim të Strellcit të Epërm dhe kur afrohet në afërsi të shtëpisë së Naser Pajazitajt, kaloi i pandehuri Naser Pajazitaj me veturën e tij, i cili u ndal dhe e mori viktimën me veturë.

UP-ja dhe Ministria e Industrisë bëjnë marrëveshje bashkëpunimi për Qendrën e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë

PRISHTINË, 7 PRILL - Rektori i Universitetit të Prishtinës, Qerim Qerimi dhe ministrja e Industrisë, Rozeta Hajdari, kanë nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit për finalizimin e projektit të Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në kuadër të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në UP.

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është investimi në Qendrën e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në UP për rregullimin dhe furnizimin me pajisje të hapësirës së përbashkët për zhvillimin e ideve dhe projekteve inovative

për personat fizikë dhe bizneset fillestare (Start Up) me qëllim të parapërgatitjes dhe zhvillimit të veprimtarive të ndërmarrësve inovatorë. Rektori Qerimi u shpreh i nderuar që ky investim po bëhet në Universitetin e Prishtinës. Ai ka theksuar se ekziston mundësia që përmes kapacitetit profesional dhe ekspertizës që ka UP-ja, nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit ndërmjet industrisë dhe akademisë, të kontribuohet në zhvillimin e ideve dhe projekteve inovative për studentët, stafin akademik të UP-së, bizneset fillestare dhe komunitetin.

Investimi në shumën e përgjithshme 1 000 000 euro (një milion euro) nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës, në Qendrën e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, përfshinë fazën e fundit të investimeve në vlerë 150 000 euro (njëqind e pesëdhjetë mijë euro) që do të zbatohet përmes marrëveshjes aktuale të bashkëpunimit, për investime në adaptimin e hapësirës së përbashkët për ndërmarrësit e rinj, si dhe për krijim të bashkëpunimeve të strukturuar në mes të akademisë dhe industrisë. Qendra e Inovacionit dhe



Ndërmarrësisë do të ofrojë hapësirë fizike dhe ekspertizë të nevojshme për shumë ndërmarrës të rinj për mbështetje në zhvillimin e

ideve inovative dhe projekteve ndërmarrëse që nga faza e parainkubimit, inkubimit e deri të lansimi i produktit final.

Arsimi dhe aftësimi profesional, Avokati i Popullit: Nuk është në përputhje me kërkesat e tregut të punës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 PRILL - Avokati i Popullit, në kuadër të ushtrimit të kompetencave dhe të përgjegjësisë të tij ligjore, ka publikuar raportin me rekomandime Ex-officio nr. 676/2022, që ka të bëjë me arsimimin dhe mundësitë e të rinjve në tregun e punës. Bëhet me dije se qëllimi i këtij raporti ka qenë vlerësimi i nivelit të harmonizimit të arsimimit të të rinjve në institucionet e arsimit të lartë dhe profesional në Kosovë me kushtet e punës. Raporti analizon edhe kontekstin ekonomik, cilat janë vendet e punës në dispozicion në Kosovë dhe segmente të tjera. Po ashtu, raporti ka analizuar qasjen në arsim dhe arrijtjet arsimore, cila është qasja në arsim për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe për nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë dhe fusha të tjera të përfshira në procesin e analizës. Raporti përfshin edhe analizën e ofertës dhe të kërkesës së fuqisë punëtore.

Avokati i Popullit konstaton se pas analizës së legjislacionit përkatës, hulumtimeve të mëparshme, të politikave, të informatave dhe të të dhënave

që i ka IAP-ja lidhur me çështjen, del se gjatë dekadës së fundit Kosova ka shënuar përparim në fushën e zbatimit të të drejtave të njeriut në arsim. "Ky përparim, megjithatë, nuk ka qenë i barabartë në nënsektorë të ndryshëm për sa i përket pjesëmarrjes, përfshirjes dhe zhvillimit të të rinjve sipas nevojës dhe aftësive të tyre", thuhet në raport.

Sa i përket arsimit dhe aftësimit profesional në Kosovë, Avokati i Popullit konstaton se nuk është në përputhje me kërkesat e tregut të punës. "Kur është bërë analizimi i të dhënave që lidhen me kërkesën e tregut të punës, si punësimi, brutoproducti vendor sipas sektorëve ekonomikë dhe struktura e bizneseve, me numrin e nxënësve sipas profileve, ka dalë që nuk janë në përputhje", theksohet në raport.

Raporti, ndër të tjera, ka gjetur se më shumë se 80 për qind e programeve profesionale kanë mungesë të materialeve dhe të teksteve të përshtatshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie në institucionet e arsimit profesionale, duke vështirësuar të mësuarit e duhur dhe praktik. Avokati i Popullit ka nxjerrë rekomandime për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë



dhe Inovacionit, e cila, ndër të tjera, rekomandohet të hartojë politika dhe të ndërmarrë masa konkrete që të sigurojë që sistemi i arsimit dhe aftësimit profesional të jetë i ndërlidhur

me kërkesat e tregut të punës. Po ashtu, edhe Agjencia e Kosovës për Akreditim është rekomanduar, ndër të tjera, që të kërkojë evidencë për ndërlidhjen e programeve të

studimit me kërkesat e tregut të punës si dhe t'i mbajë statistikën për programet e studimit që nuk kanë përmbushur standardin për të qenë në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Për një javë 1 175 gjoba për kundërvajtësit në trafik

GJILAN, 7 PRILL - Drejtorja Rajonale e Policisë në Gjilan, Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor dhe Stacionet Policore të Drejtorisë Rajonale të Policisë - Gjilan, gjatë periudhës kohore 31 mars dhe 7 prill, në vazhden e implementimit të planeve

operative "Siguria në trafikun rrugor" dhe "Sezoni dimëror", kanë realizuar aktivitete në zonën e përgjegjësisë që mbulon shtatë komuna. Gjatë kësaj periudhe janë shqiptuar 1 175 gjoba për kundërvajtësit të cilët kanë rënë ndesh me ligjin për rregullat e trafikut rrugor. Po

në kuadër të këtyre planeve janë ndërmarrë aktivitete edhe për hetimin e dymbëdhjetë aksidenteve të komunikacionit me dëme materiale, hetim në dymbëdhjetë aksidente të komunikacionit me të lënduar dhe janë konfiskuar tetëmbëdhjetë patentëshoferë.



Kurti: Do t'i mbështetim qytetarët që shpenzojnë deri në 800 kilovatë energji elektrike

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë një takimi me kryetarët e komunave, ka thënë se do t'i mbështet qytetarët pas vendimit të fundit për rritje të çmimit të energjisë. I pari i qeverisë ka thënë se do t'i subvencionojnë familjet që shpenzojnë deri në 800 kWh energji në muaj, ndërsa grupet e cenushme do të kenë trajtim të veçantë

EPOKA E RE**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 7 PRILL - Kryeministri Albin Kurti së bashku me ministren Artane Rizvanolli, ministrin Hekuran Murati dhe Elbert Krasniqi, përfaqësuesin e Zyrës së BE-së Alessandro Bianciardi e drejtorin e Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë, Ahmet Ismailim ka prezantuar para kryetarëve të komunave masat që do të zhvillojnë në kuadër të Pakos Emergjente të Bashkimit Evropian nga të cilat do të përfitojnë qytetarët e të gjitha komunave.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se pakoja emergjente 75-milionëshe nga Bashkimi Evropian për përballje me krizën energjetike do të përdoret për përkrahjen dhe mbrojtjen e qytetarëve nga kjo krizë. "Ndhima e menjëhershme buxhetore prej 75 milionë eurosh për Kosovën, për ballafaqim me krizën energjetike, është jetësim i kërkesave tona dhe i përkrahjes

së Bashkimit Evropian për sektorin tonë energjetik. Këtë pako financiare jemi siguruar ta dizajnojmë në mënyrë të tillë që ta rritim ndikimin e masave që i kemi marrë si qeveri për t'i përkrahur e mbrojtur qytetarët në përballje me krizën energjetike", ka thënë kryeministri Albin Kurti.

I pari i qeverisë ka thënë se do t'i subvencionojnë familjet që shpenzojnë deri në 800 kWh energji në muaj, ndërsa grupet e cenushme do të kenë trajtim të veçantë. "Mbështetja jonë ndaj qytetarëve do të vazhdojë edhe pas vendimit të fundit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) ku, ndër të tjera, do t'i subvencionojmë familjet për konsum të energjisë deri në 800 kilovatë orë në muaj, kurse grupet e cenushme siç janë familjet në asistencë sociale do të kenë trajtim të veçantë. Me rreth 9 milionë euro kemi rinovuar e bërë eficientë 70 ndërtesa publike, shkolla, çerdhe të fëmijëve, qendra shëndetësore e stacione të zjarrfikësve, duke e



rritur kështu komfortin e duke e ulur konsumin e energjisë. Gjatë dimrit që tashmë po e lëmë pas kemi parë rezultate të menjëhershme të këtyre masave të cilat i kemi ndërmarrë si qeveri falë mbështetjes së bashkëpunimit me Bashkimin Evropian (BE). Këto masa të dëshmuara po shumëfishojnë edhe përfitimet për qytetarët e për bizneset e vendit tonë", ka

thënë Kurti.

Ndërkaq ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka dhënë detaje se si do të ndahen këto mjete. "Me pakon në vlerë prej 75 milionë eurosh do të ndajmë: 10 milionë për subvencionim të pajisjeve eficiente për familje, 5 milionë për subvencionim të pajisjeve eficiente për biznese, 25 milionë mbështetje e drejtpërdrejtë financiare për

familjet në nevojë, 15 milionë për nxitje të kursimit të energjisë, 10 milionë për investim në eficiencë në shtëpi private banimi dhe 10 milionë për investim në eficiencë në ndërtesa shumëbanesore të destinuar për banim social. E për këtë të fundit i kemi njoftuar kryetarët e komunave të vendit për mundësitë për aplikim pasi thirrja është e hapur që nga sot", ka thënë Rizvanolli.

Oda Ekonomike organizon takim të përbashkët Kosovë - Shqipëri, diskutohet për zgjidhjen e problemeve në portin e Durrësit

PRISHTINË, 7 PRILL - Oda Ekonomike e Kosovës ka organizuar takimin e përbashkët Kosovë - Shqipëri së bashku me Shoqatën e Importuesve të Mishit. Në takim pjesëmarrës ishin ambasadori i Shqipërisë, Qemal Minxhozi, përfaqësuesit e Doganës së Shqipërisë, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Policia Kufitare, ndërsa nga ana e Kosovës pjesëmarrës ishin kryetari i OEK-ut, Lulzim Rafuna, kryetari i Shoqatës së Importuesve të Mishit, Valdet Gjinovci, përfaqësuesit e Doganës së Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe operatorët e biznesit të cilët merren me importin dhe përpunimin e produkteve me prejardhje shtazore (mishit të ngrirë).

Në takim u diskutua për zgjidhjen e problemeve në portin e Durrësit, për produktet me prejardhje shtazore të cilat vijnë nga importi, vonesat të cilat janë duke u shkaktuar gjatë procesit të



kontrollit, ku në diskutim prioritet iu dha zgjidhjes së problemit dhe thjeshtësimit të procedurave të kontrollit me qëllim të kalimit më

të shpejtë të tyre dhe uljes së kostos së shpenzimeve.

Si problematika aktuale të paraqitura nga komuniteti i

biznesit në sektorin e industrisë së mishit të cilat janë duke ndodhur në Portin e Durrësit dhe janë diskutuar në takim: Skanimi i

ngarkesave, pritjet e gjata për kontroll të cilat shoqërohen me kosto të larta nga qëndrimi i ngarkesave në port dhe procedura joadekuate gjatë realizimit të kontrollit të produkteve me prejardhje shtazore (mishit të ngrirë).

Bizneset nuk e kundërshtojnë procesin e kontrolleve zyrtare, por kërkojnë lehtësim dhe përsheptim të këtyre procedurave që bizneseve mos t'u shkaktohet kosto.

Kërkesë e bizneseve - importuesve nga Kosova - ishte që ky proces i kontrollit të kryhet në Kosovë nga Dogana e Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, institucionet ligjzbatuese.

Ambasadori i Republikës së Shqipërisë, Qemal Minxhozi, ka potencuar se dialogu për zgjidhjen e problemeve është thelbësor dhe ka përkrahur që kjo çështje të adresohet tek autoritetet shtetërore shqiptare dhe të ofrohet zgjidhje praktike, të eliminohen këto barrierat mes dy vendeve.

AJAZ EMINI - Ditar (XI)

NJË JETË KUSHTUAR ATDHEUT

Tani me këtë leje udhëtimi shumë gjëra u bënë shumë më të lehta për ne si familjarë, na u dha mundësia që pas pune, vikendin të shkojmë e ta kalojmë të gjithë së bashku me të gjithë familjen në Llojan. Pas disa muajsh blemë edhe një makinë nga një i afërm i yni me të cilën gjithëçka u lehtësua edhe më tepër për ne dhe familjen në përgjithësi.

Nga padrejtësitë e mëdha që po i bëheshin popullatës shqiptare në Maqedoni, gjatë kësaj kohe në Karadakun e Kumanovës filluan edhe lëvizjet e përgaditjeve të popullatës për luftë. Në fshatin Llojan veçse filluan me ardhjen e parë vëllezërit kosovarë për të bërë organizimin e luftës, si dhe për të luftuar ballë për ballë kundër armikut sllavo-maqedon. Gjatë udhëtimit tonë prej Kumanovës për në fshatin Llojan kishim disa pika kontrolli policore (punte policore), njëra prej këtyre pikave ishte ajo afër hekurudhës në mes fshatit Vaksincë dhe Reçicë. Kjo pikë kontrolli e policisë maqedone që ishte aty, gjithmonë ishin 3-4 policë. Gati se çdo herë kishte ndonjë prej tyre që fliste nga pakë dhe anglishten, dhe pas së cilës ndalesë tonën në këtë pikë kontrolli, ata ishin tepër të dyshimtë për lëvizjet tona. Po, sepse gjatë kontrollës tonë ata po na shihnin se ne me dokumentacion ishim nënshtetas amerikanë. Pastaj ishim edhe me veshje ushtarake amerikane, kishim kartelat e njoftimit (Badges) të KFOR-it, kurse makinën që po i grahnim ishte me regjistrim dhe sigurim të shtetit austriak! Ajo çka më tepër i irritonte këta policë kontrolle, ishte se ne nuk i flisnim asnjëherë në asnjë gjuhë sllave, gjuha jonë e vetme me të ishte shqipja ose anglishtja! Pas ndalesës dhe gjatë kontrollës së makinës, na urdhëronin të hapim edhe gepekun e makinës, aty ku mbanim xhaketat dhe helmetat ushtarake anti-plumb.

Shpeshherë ata i ktheheshin njëritjetrit dhe i thonin në gjuhën maqedone: "A mos janë spiunë këta njerëz, i sheh janë të mobilizuar dhe me veshje ushtarake të KFOR-it?" Ishte koha gjatë prillit 1999, derisa po ktheheshim prej Llojanit për në punë përsëri na ndali policia maqedone në pikën e përhershme të kontrollit policorë që kishin nën fshatin Vaksincë. Tani ishte koha kur po priteshin edhe krismat e para të luftës frontale shqiptare kundër pushtetit maqedon. Gjithëkund flitej se lufta ishte e mundur se do të fillojë në çdo moment. Sulmi i parë që po planifikohej tani, do të ishte sulmi mbi autobllindën e policisë kufitare maqedone e cila ishte në kthime nga pika kufitare Miratoc-Llojan për në Kumanovë gjatë ndërrimit të tyre të policisë kufitare.

Pas ndalimit tonë dhe pas kontrollit që na bënë, njëri nga policët më pyeti maqedonisht,



por unë i thashë se ne nuk njohim gjuhët slave. Por, mundë të komunikojmë vetëmse shqip apo anglisht po deshtë. Pastaj njëri e filloi në Anglishten e deformuar të në bëjë pyetje se prej nga po vinim? I tregova se tash po ktheheshim nga fshati Llojan. Polici menjëherë ma priti: "Po si keni guxu me shku në fshatin Llojan, kur atje janë grupet terroriste?" Unë ia ktheva menjëherë: "Si më the, ti neve tani po na quan terrorist?" pastaj ndërhyri njëri prej shokëve të tij, edhe me një anglishte pak më të mirë më tha: "Jo, Jo, nuk po të quan ty terrorist, por po të thotë se atje lartë në fshatin Llojan qëndrojnë grupet terroriste", edhe pse prej fillimit ne e kuptuam shumë mirë se ku e kishte fjalën polici sllavo-maqedon! Deri sa ne po sqaroheshim me këtë policin maqedon, e ndëgjova tjetrin polic duke i thënë shokut të tij: "Liroje më shpejtë se pastaj ata shkojnë atje poshtë dhe bëjnë ankesë në KFOR, edhe munden me na çitë probleme!"

Pas kontrollit ne vazhduam rrugën për në Shkup e pastaj nëpërmjet Grykës së Kaçanikut për në kampin "Bondsteel" të Sojevës. Gjatë rrugës në drejtim të Shkupit, pas daljes prej qytetit të Kumanovës në hyrje të pagesës së autostradës, gjithmonë edhe aty iu sjellsha telashe, sepse asnjëherë nuk ia paguaja taksën e autostradës. Diçka e tillë i irritonte pa masë punëtorët e mbledhjes së asaj takse, për shkak se edhe pse isha me uniformë ushtarake ne po i grahnim makinës private, dhe sipas rregullave ne duhej që ta paguanim këtë takes. Mirëpo uniforma e Armatës Amerikane disi i frikësonte që të më ndalonin, dhe të na detyronin që të paguajmë këtë taksë rrugore! Këtë e bëja më tepër nga mllëfi që kisha për pushtetarët sllavë, të cilët tërë jetën na kishin nënçmuar si qenie njerëzore, edhe pse ne ishim popullata më e vjetër dhe autoktone e këtyre tokave të Dardanisë.

Të njëjtën "arrogancë" si me

thënë e bëja thuajse gati se sa herë që kaloja kufirin Kosovë-Maqedoni apo anasjelltas, kur polici kufitar maqedon më kërkonte pasaportën të cilën e kisha me vete por nuk ia jepsha që të kontrollohej. Shfrytëzonim vetëmse kartelat e KFOR-it amerikan, edhe atëherë kur nuk shfrytëzonim hyrje-daljet speciale që i kishim ne si pjesëtarë të KFOR-it.

Derisa po punonim me njësinë e jurispodencës ushtarake JAG në Bondsteel, patëm edhe viktimën e parë të Armatës Amerikane në Kosovë e që kishte ra në mina më 15 Dhjetor 1999 diku në afërsi të Kamenicës. Quhej Joseph Suponic, ishte nga Pensilvanya



me prejardhje Sllovene, dhe që fliste edhe serbo-kroatishten, ishte i qetë, mjaftë profesional dhe me sjellje shumë të mira. John, siç e quanim, ishte njëri nga pjesëtarët e grupit të Njësisë së Forcave Speciale të Armatës Amerikane, me të cilin kishim jetuar dhe bashkëpunuar, dhe njiheshim nga Kukësi, në Shqipëri, atje ku po shërbenim në koordinimin e bombardimeve të aviacionit të NATO-së mbi forcat paramilitaro-ushtarake serbe. Meqenëse John njihnte serbo-kroatishten, pas ardhjes në Kosovë ai u caktua me njësinë e tij si person ndërlidhës me forcat ruse, që ishin të stacionuara në Kamenicë. Më 15 Dhjetor 1999 derisa John me kolegët e tij po udhëtonin me Humvee diku në

afërsi të Kamenicës, kishin ra në një minë dhe makina e tyre ushtarake Humvee rrokulliset dhe lëndohen dhe nga lëndimet e marra Johni vdes.

Më vonë në lidhje me këtë rast forcat ruse kishin arrestuar një ish komandant të UÇK's të cilin po e akuzonin se ai ishte personi që kishte vënduar minën në rrugë. Ai ishte Komandant Rahim Beqiri i quajtur "Roki"! Me Rahim Beqirin u njohëm nga Gjykata e Gjilanit, aty ku ai po mbahej si i dyshuar për vrasjen e ushtarit amerikan, që ishin sipas të dhënave të grupit hetues të ushtrisë ruse në Kamenicë. Meqenëse akuza kishte të bënte me vrasjen e ushtarit amerikan, Kapiteni Heslini JAG-ut të Armatës Amerikane me të cilin po punonim tani një kohë, dhe një shok i mirë i yni na tha që t'i themi Kryetarit të Gjykatës së Gjilanit Ymer Huruglicës, që ta sjellin Komandant Rokin lartë në zyrën e gjykatës që ta ndëgjoje në lidhje me akuzën. Pas pak minutash Zotëri Huruglica e solli komandanin e UÇK's që po mbahej aty, i shoqëruar nga një pjesëtarë i policisë së burgut. Policin shoqërues të burgut e urdhëruam që të dalë nga zyreja, që i akuzuari të jetë më i lirë gjatë bisedës. Gjatë marrjes në pyetje të Komandant Rokit u pa se ai nuk kishte lidhje me këtë incident, edhe pse ky ishte më tepër plani rus që t'ia mveshin vrasjen ndonjërit prej pjesëtarëve të UÇK's. Po, pasi se trupat ruse nuk i kishin në sy të mirë pjesëtarët e UÇK's dhe ishin shumë pro serb. Pas pak minutash kapiteni doli nga zyra, mbetëm vetëm unë me Komandant Rokin, edhe në



10 Maj 2000 Sojevë /Kosovë, tani në punë së bashku me Shahadijen në Njësinë e Jurispodencës së Armatës Amerikane "JAG" në kampin "Bondsteel"

hajgare e pyeta prej nga e morët emrin Roki? Komandanti tha: "Ishim në një akcion kundër forcave serbe, dhe pas fitores së atijë akcioni prej qefit që i mundëm, hypa mbi tankun serb, kur të gjithë bashkëluftëtarët e mi filluan të më thërrasin Roki, Roki, Roki sepse iu duk skena diçka si nga filmat "Roki" të Silvester Stalones. Prej atijë rasti më mbeti gallapi Komandant "Roki." Më vonë e pyeta se: "Çfarë planesh ke, sepse tash Kapiteni Heslin do t'i japë urdhër gjykatës që të lirojnë, se nuk kanë kurrëfarë arsye dhe mos t'ju mbajnë për këtë akuzë. Ka mendim të njejtë edhe Kryetari i Gjykatës së Gjilanit Ymer Huruglica se kjo akuzë ishte vetëmse sa për të njoosur ish pjesëtarët e UÇK's." Nga ky lajm u gëzua shumë Komandant Roki dhe vazhdoi se "Unë nuk do të ndalem së luftuari për të drejtat e shqiptarëve kudo që janë, e kismet si të dalë prej këtu menjëherë do t'i bashkangjitem shokëve të mijë në Maqedoni"!... Disa fjalë për Rahim Beqirin-Komandant Roki: Ishte i lindur në fshatin Koprivnicë të Kamenicës. Më 1988 i bashkangjitet forcave të UÇK's dhe bëhet komandant në zonën e Marecit, më vonë kalon në UÇPMB (Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc) në luftërat e Luginës së Preshevës. Në vitin 2001 shkon në Maqedoni edhe i bashkangjitet forcave të UÇK-së (Forcave Çlirimtare Kombëtare). Gjatë luftimit në Drenovc të Tetovës kundër forcave maqedone plagoset rëndë dhe pas transferimit të tij në spitalin e Prishtinës më 2 Gusht 2001 ndërrohet jetë për të mos vdekur kurrë!

Lavdi veprimtarisë së këtijë heroi kombëtarë, i cili nuk kurseu as jetën e tij për lirinë dhe të drejtat e shqiptarëve!

FILLIMI I LUFTIMEVE NË RRETHIN E KUMANOVËS - MAQEDONI

Gjatë Prillit 2001 pritej shpërthimi i luftimeve kundër forcave sllavo maqedone edhe në fshatrat e Kumanovës. Tani në të gjitha anët

po flitej vetëmse kur do të fillojnë luftimet. -Në fshatin Llojan tani unë me Shahadijen po kalonim çdo vikend, sepse aty kisha vajzat dhe të gjithë familjen. Sipas të gjitha bisedave atje po planifikohej që sulmi i parë kundër forcave maqedone të fillojë në fshatin Llojan, atëherë kur do të kthehej patrulla policore me autobлиндën e tyre nga kufiri Llojan-Miratoc. Mirëpo siç u tha nga bisedat se për shkak të armatimit jo të mjaftueshëm në Llojan, vendosin që sulmi të kryhet në fshatin Vaksincë.

Luftimet në mes të UÇK-së dhe forcave maqe- donase kishin fillu qysh herët në fshatin Tanushë, mirëpo konflikti filloi më 22 Janar 2001 kur forcat e UÇK-së kishin sulmuar stacionin policor në fshatin Tearcë të Tetovës, ku kishin vrarë 1 oficer policor dhe kishin plagosur 3 të tjerë. Pas këtijë akcioni siç duket, fillojnë përfocimet e UÇK-në rajonin e Kumanovës të rriten. Në këtë pjesë të banuar kryesisht me shqiptarë, tani kishim të ardhur edhe shumë veteran të luftës nga Kosova edhe Shqipëria.

Meqenëse ishin festat e Majit, i porositëm që për festë vajzat tona: Liridona dhe Mimoza që të shkojnë te motra ime Nergjizja në fshatin Çerkez, e kurëse ne do të vinim aty të Premten. Të Premten ne shkuam te motra në Çerkez, takuam vajzat tona dhe ndejtëm deri të Dielën në mbrëmje, dhe para nisjes për në Bondsteel i porositëm vajzat që pas feste të ktheheshin te familja ime në Llojan. Kurse ne shkuam përsëri për në punën tonë në kampin ushtarak të Bondsteel'it, me premtimin se gjatë vikendit tjetër do të jemi me to në fshatin Llojan. Pas kthimit tonë në kampin ushtarak në Sojevë, më 3 Maj 2001 ndodhi sulmi mbi patrullën policoro- ushtarakë maqedone në fshatin Vaksincë, rreth 1 km nga fshati Llojan. Në këtë sulm të UÇK-së u vranë 2 ushtarë maqedon kurse i treti ushtarë u zu rob lufte, dhe zona shqipëtare për rreth maleve të Karadakut u shpall "Zonë e lirë" nga forcat e UÇK-së Po në të njejtën ditë fillon ofanziva maqedone kundër forcave të UÇK-së, kurse fshatarëve iu jipet ultimatum që



13 Shkurt 2008 Lakewood /SHBA, me mikun e madhë të shqiptarëve, Kongresmenin Amerikan Eliot Engel

për menjëherë për t'u larguar nga fshatrat për rreth. Sulmet fillojnë nga forcat sllavo maqedone me artileri, tanke, mina hedhës si dhe helikopterët ushtarak. Së pari sulmi maqedon filloi mbi fshatrat: Vaksincë, Sllupçan, Orizare dhe Hotël. Pas dy jave lufte të rreptë të UÇK-së me forcat maqedone, fshatrat shqiptare granatohen pamëshirshëm: Llojan, Vaksincë, Sllupçan, Orizare, Likovë, Hotël, Mateç e deri në Haraçinë. Kurse më 26 Maj 2001 në fshatin Vaksincë vritet heroi i kombit Fadil Nimani Komandant Tigri, i cili ishte veteran i luftës së UÇK-së në Kosovë e tani kishte ardhë nga Kosova për t'i ndihmuar vëllezërit e tij shqiptarë në rrethin e Kumanovës. Gjatë kësajë kohe, rruga për në fshatrat shqiptare rrëzë maleve të Karadakut ishte mbyllur. Vajzat na mbetën në fshatin Çerkez te motra, kurse nëna e sëmurë, familjarët tjerë në fshatin Llojan.

Tani po pritej nga momenti në moment që edhe në fshatin Çerkez të fillojnë luftimet. Në një anë, rreth stacionit hekurudhorë të Kumanovës, përballë fshatit Çerkez mbi silosin e betonit shifeshin snajperistët maqedon që ishin të gatshëm për gjuajtje në popullatën e pa mbrojtur

shqiptare. Ndërsa vetëm disa qindra metra më tutje, gjendej edhe kazerma ushtarakë maqedone e cila ishte në gjendje gadishmërie, e kurëse në anën tjetër kishte disa pjesëtarë të UÇK-së që vinin rregullisht në ndejtë tona, ku ishim me dhëndërrin Sabri Asani -Drejtor Shkollë, Feriz Dervishin - Këshilltarë Komunal dhe biznesmen i madh si dhe shoqëria e tyre, për t'i kërkuar lejen e fillimit të aksionit luftarak edhe në këtë fshat. Mirëpo ishte Feriz Dervishi ai i cili rregullisht e përmbajti kontrollin e pjesëtarëve të UÇK's po dhe të forcave maqedone, për mos shpërthimin e një lufte shumë të përgjakshme të popullatës së pa armatosur në fshatin më të madh të komunës së Kumanovës e cila është banuar kryesisht me shqiptarë, dhe pothuajse lagje e qytetit.

Meqenëse nuk mundë të shkoja në fshatin Llojan, tani vikendet po i kalonim së bashku në fshatin Çerkez te motra me dhëndërrin Sabriun dhe familjen e tyre. Gjatë mbrëmjeve sa ishim në fshatin Çerkez kohën më të gjatë po e kalonim së bashku me shoqërinë e Sabriut mbrenda fshatit. Prej fshatit Çer-kez patëm rastet e shumëta që t'i shohim edhe granatimet e pa mëshirëshme të fshatrave tona shqip- tare që ishin për ballë, nga forcat sllavo maqedone.

Te motra kishim edhe vajzat tona që mbetën të ngujuara në fshatin Çerkez, sepse dokumentacioni me veshëmbathjen e tyre i mbeti në zonën e çliruar të Llojanit! Gjatë vikendit vendosëm që vajzat t'i transferojmë në Kaçanik te familja e Shahadijes, mirëpo si t'ia bëjmë?! Ato nuk kishin pasaportat me vete! Tani po flitej se edhe rruga për në fshatin Çerkez do të mbyllej, atëherë në mbremje vonë morëm vajzat edhe u nisëm për në qytetin e Kumanovës te kusherira Mifiraja, aty kaluam natën dhe të nesërmen para darke të Dielën më 6 Maj 2001, u nisëm drejtë kufirit të Elez Hanit.

Në kufi ishte pamje e trishtueshme, kallaballëk i madh, plotë gra edhe fëmijë që më tepër i përngjante kohës kur shqiptarët po iknin dhe dëboheshin nga Kosova për në Maqedoni por tani ishte e kundërta, hqiptarët po

iknin prej Maqedonisë për në Kosovë! - Në zonën kufitare unë nxorra kamerën edhe po bëja disa inçizime të refugjatëve që po iknin për në Kosovë kur nga ana tjetër më bërtiti policia kufitare maqedone: "Çka je duke bërë, a e dinë se nuk lejohet inçizimi në kufi?" Unë ia prita anglisht: "Kush po të pyet ty?" Polici maqedon gadi sa s'u çmendë, tani ma kërkonte kamerën që të ma marrë sepse paskam thyer ligjin e tyre. Unë i thashë se: "Kamerën nuk ta jap, kjo është e imja!" Policist gadi sa nuk iu muar zëri nga piskama duke e kërkuar që t'ia japë kamerën atijë, ishim të parët në kolonë të qindra makinave pas neshë, dhe kishim bërë bllokim total të trafikut kufitarë. Tani polici nuk na lejonte që të kalojmë kufirin por ai më thonte se: "Ju nuk keni për ta kalu kufirin nëpërmjet kësajë pike kufitare, por tani ju duheni të ktheheni në pikën kufitare të Tabanocit". Unë ia ktheva se: "Unë kamë për të kaluar vetëm këtu e askund tjetër", atëherë polici hyri mbrenda edhe e thirri shefin e tij i cili ishte një polic tjetër i cili na u afrua edhe më pyeti se çka është problemi? I thashë "Nuk e kuptoj se çka është çmendur ky kolegu juaj, e s'po don me na lënë që të kalojmë në rrugën tonë për në punën tonë në Bondsteel." Polici u afru edhe po i tregonte si unë kisha inçizu mbrenda kufirit, unë ia prita: "Nuk është aspakë e vërtetë, eja shife aparatin, ky është aparat fotografik e jo kamerë inçizuese!" Shefi i policisë u afrua edhe e pa se ishin foto që kisha fotografu në vende tjera, edhe mu drejtua me fjalë të mira; "Të lutem ta kesh parasysh e mos fotografo në zonën kufitare sepse është e ndaluar. E shef atje shenjën më largë ku të tregon se është zonë e ndaluar për të bërë foto këtu", edhe na e hapi krahun e rrugës edhe kaluam në anën tjetër të kufirit, në anën Kosovare, pa passaportat e Liridonës dhe Mimozës. Sa për kamerën, ajo ishte në realishtë kamerë që kisha bërë inçizime, por kishte edhe pullën tjetër që të bëja edhe vetëmse fotografi. Ato të cilët edhe ia tregova shefit të policisë në kufi!



2005 Cleveland /SHBA, së bashku me themeluesen e shoqatës shqiptare, Këshilltaren e qytetit, arbëresho-amerikanen Dona Brady dhe Don Brady.

Fuqia mbrojtëse e nostalgjisë



Nga Arthur C. BROOKS

Që nga fillimet e lidhjes sonë në mesin e të 20-tave, gruaja ime ka mësuar vendndodhjen e një vendi mistik të quajtur Lincoln City. Është një qytet modest në bregun qendror të Oregonit, por për mua, ai mban një mit të ngjashëm me Shangri-la. Lincoln City është vendi ku kaloja një javë të lumtur çdo vit kur isha i vogël, duke peshkuar pranë skelës, dhe duke luajtur me shkrepe në vatrën e zjarrit jashtë shtëpisë-kamping të tezes sime. Ato janë kujtimet më të lumtura të fëmijërisë sime. Kështu, duke pasur shumë pritshmëri, jo shumë kohë pasi u martova, e çova gruan time për të vizituar vendin që sipas meje është më i miri në botë. Për mua ishte ende po i aq i magjishëm sa e kujtoja. Për të, jo dhe aq. Në atë kohë ajo ishte muajt e fundit të shtatzënisë, dhe nuk mund të duronte erën e rëndë të peshqve të ngordhur. Duke qenë se është më origjinë nga brigjet e ngrohta të Mesdheut, nuk duhet të isha çuditur që ajo e kaloi fundjavën e mbyllur në dhomën tonë në një motel për të shmangur erën kutëruese. Që nga ajo kohë ajo e ka konsideruar Lincoln City si një

defekt në matricën time psikologjike. Një dashuri e pashpjegueshme, thujse patologjike, pa asnjë bazë në realitet. Normalisht, vlerësimet e mia për një vend apo përvojë ndryshojnë pak ose aspak nga ato të gruas sime. Nëse ajo urren një festë, ndoshta e urrej edhe unë. Në këtë rast, perceptimet tona tejet të ndryshme për Lincoln City mund të shpjegohen me një nga ndjenjat më të çuditshme dhe më të fuqishme që zotërojnë njerëzit: nostalgjinë. Kjo përzjerje e kujtesës, emocionit dhe dëshirës mund të shtrembërojë perceptimet dhe gjykimet tona, duke e kthyer edhe dhimbjen në kënaqësi. Apo erën e peshkut të ngordhur në parfumin francez më të ëmbël. Dhe kjo i jep asaj një fuqi unike për të luftuar palumturinë. Psikologët e kanë përcaktuar nostalgjinë si një emocion të vetëdijshëm, social, të hidhur, por kryesisht pozitiv. Ajo zhvillohet nga kujtimet e lumtura, të përziera me dëshirën për të kaluarën dhe marrëdhëniet e ngushta që kishim në atë kohë. Shpeshherë nostalgjia përfshin stimuj ndijorë. Për shembull, aroma e gjetheve të vjeshtës mund të provokojë një

dëshirë të madhe për shtëpinë tuaj të fëmijërisë. Neuroshkencëtarët kanë zbuluar se nostalgjia është një dukuri konjitive komplekse që përfshin shumë pjesë të trurit, përfshirë disa që lidhen me vetë-reflektimin, kujtesën autobiografike, rregullimin emocional dhe përpunimin e shpërblimeve. Gati të gjithë njerëzit përjetojnë nostalgji, edhe pse objekti i saj priret të ndryshojë gjatë gjithë jetës. Një sondazh i kryer nga psikologja Krystine Irene Batcho, zbuloi se të rinjtë ndjenin më shumë nostalgji për kafshët shtëpiake, lodrat dhe pushimet sesa të moshuarit, të cilët e ndjenin më fort muzikën. Siç ka shkruar kolegja ime Julie Beck, kur u përcaktua për herë të parë në fundin e shekullit XVII-të nostalgjia cilësohej si një sëmundje emocionale. Dhe më e rëndësishmja: Ajo ndodh shpesh kur njerëzit përjetojnë një humor negativ ose kanë përvoja të këqija. Siç zbuluan studiuesit në vitin 2008, një arsye mund të jetë vetmia. Një tjetër është moti i keq. Apo njëkëngë e caktuar. Megjithatë, pavarësisht lidhjes së saj me emocionet negative, nostalgjia nuk shkakton apo e përkeqëson palumturinë. Përkundrazi, ajo është një

përgjigje mbrojtëse ndaj saj, dhe sjell lehtësim nga një gjendje psikologjike negative. Duke pasur parasysh përfitimet prej saj, ja cilat janë 3 mënyrat sesi mund ta përdorim atë me efikasitet kundër humorit të keq:

1. Mbani me vete një foto apo objekt që ju kujton vendin tuaj të lumtur

Mendoni për kujtimin e një vendi dhe një kohe specifike që ju jep një ndjenjë ngrohtësie, qëmund ta ndërmendni në momentet e stresit. Pastaj gjeni një foto apo objekt që ju kujton atë vend dhe mbajeni pranë. Ndoshta është një këngë e ruajtur në telefonin tuaj apo një foto juaja si fëmijë ulur në prehrin e gjyshes. Ose nëse është e mundur, gjeni diçka që mban një erë që e stimulon nostalgjinë. Studiuesit kanë zbuluar se nostalgjia e shkakton nga aroma mund të jetë veçanërisht efektive në rritjen e lumturisë, vetëvlerësimit, optimizmit dhe lidhjes sociale.

2. Parashikoni kujtimet tuaja

Kur mendoni për kujtimet që nxitin tek ju nostalgjinë, ato ndoshta perceptohen si diçka fatlume. Por kujtimet tuaja

nostalgjike mund të kenë të njëjtin efekt edhe nëse prodhohen qëllimisht. Në një studim të vitit 2019, studiuesit raportuan se kur njerëzit prisnin të ndjeheshin nostalgjikë për një përvojë aktuale, ata kishin më shumë gjasa ta përjetonin atë nostalgji më vonë, dhe të kishin një nxitje korresponduese në ndjenjat e tyre të lidhjes sociale dhe ndjenjën e kuptimit.

3. Ndërtoni tradita

Një studiues shkroi në vitin 2021 në "Harvard Business Review" se nostalgjia mund të ndihmojë në ndërtimin e lidhjeve të forta në komunitete. Unë e kam parë vetë që ndodhë kjo gjë. Gjatë leksioneve që jap në Harvard, flas rregullisht në takimet e të diplomuarve, përfshirë edhe pensionistët që kanë mbaruar shkollën e biznesit 60 dhe madje 70 vjet më parë. Pjesëmarrësit gëzohen shumë duke parë shokët e tyre të klasës, dhe duke kujtuar kohët e tyre të vjetra të kaluara së bashku. Edhe ju mund të krijoni më shumë nga këto lidhje të forta në familjet tona, grupet e miqve dhe vendet e punës duke krijuar tradita dhe rituale dhe duke i kujtuar ato me kalimin e viteve. / The Atlantic – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Drita kërkon tri pikë ndaj Trepçës '89

Liderja e Superligës, Drita, është e përgatitur për t'i marrë tri pikë të reja në përballje me Trepçën '89 dhe për ta vazhduar rrugëtimin drejt titullit kampion. "Shpresoj se do ta japim maksimumin që ta vazhdojmë ritmin e fitoreve dhe në këtë drejtim të shkojmë drejt fundit të objektivit", ka thënë trajneri i Dritës, Arsim Thaqi



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 PRILL - Në fundjavë zhvillohet xhiroja e 28-të e Superligës në futboll. Dy ndeshje zhvillohen sot (e shtunë), tri nesër (e diel). Në këtë javë do të ballafaqohen pesë ekipet e para të klasifikimit me ato pesë të fundit. Skuadra lidere e elitës, Drita, të shtunën e pret skuadrën e Trepçës '89. Gjilanasit kanë grumbulluar 55 pikë nga 27 ndeshjet e luajtura, ndërsa mitrovicasit renditen në vendin e tetë me 29 pikë. Synim i kryesuesve është fitorja në mënyrë që të ecë drejt titullit kampion, kurse edhe 89-shi do të synojë të nxjerrë rezultat pozitiv. "Jemi përgatitur një javë për këtë ndeshje dhe, pas fitores, në ndeshjen e kaluar, gjërat ishin më të lehta. Shpresoj se do ta japim maksimumin që ta vazhdojmë ritmin e fitoreve dhe në këtë drejtim të shkojmë drejt fundit të objektivit. Kjo është ndeshje e kthimit dhe tashmë edhe lojtarët janë të vetëdijshëm që me ekipet që na kanë shkaktuar humbje morali i

ekipit të jetë më i madh. Ka lojtarë që presin momentin e tyre. Duke e ditur që këtë sezon ka pasur shumë mungesa, shpresoj që lojtarët që do të aktivizohen ta japin maksimumin dhe pastaj ta ndihmojnë skuadrën të shënojë fitore dhe të vazhdojmë drejt titullit", ka thënë Arsim Thaqi, trajneri i Dritës. Sot zhvillohet edhe ndeshja tjetër. Skuadra e dytë në renditjen tabelore, Ballkani, e pret skuadrën e Malishevës. Kampionët në fuqi kanë një pikë më pak se Drita dhe do të kërkojnë fitoren që të mbesin në hap për titull, ndërsa Malisheva kërkon pikë në mënyrë që të jetë më larg zonës së rrezikshme. Të dielën në program janë tri ndeshje të tjera. Spikat përballja në mes të Prishtinës dhe Dukagjinit nga Klina. Kryeqytetasit janë në vendin e katërt me 38 pikë, kurse në pozitën e gjashtë me 35 pikë. Në ndeshjen tjetër Ferizaj e pret skuadrën e Gjilanit, në ndeshjen ku përballen skuadrat që po kalojnë nëpër një formë të mirë në ndeshjet e fundit. Ndërsa në

ndeshjen e pestë në stadiumin "Zahir Pajaziti", Llapi nuk pritet të ketë ndeshje të vështirë, duke e parë formën jo të mirë të skuadrës së Drenicës, e cila është në vendin e dhjetë me 23 pikë të grumbulluara. Llapi i Tahir Batatinës pozicionohet në vendin e pestë me 36 pikë. Të gjitha ndeshjet e kësaj xhироje zhvillohen nga ora 15:00.

SUPERLIGA - Java 28

15:00 Ballkani - Malisheva
15:00 Drita - Trepça '89
15:00 Prishtina - Dukagjini
15:00 Llapi - Drenica
15:00 Ferizaj - Gjilani

Tabela

	Pikë
1. Drita	55
2. Ballkani	54
3. Gjilani	40
4. Prishtina	38
5. Llapi	36
6. Dukagjini	35
7. Malisheva	29
8. Trepça '89	29
9. Ferizaj	29
10. Drenica	23

SHKURT

Sonte përballja e dytë ndërmjet Ponte Prizrenit dhe Boras

Të shtunën zhvillohet dueli i dytë ndërmjet Ponte Prizrenit dhe Boras. Këto dy skuadra përballen në "play-out". Ndeshjen e parë e fituan prizrenasit bindshëm 86:123 dhe janë favoritë për ta siguruar Superligën, pasi fituesi përcaktohet nga dy ndeshjet. Prizrenasit kishin përfunduar në vendin e shtatë në Prince Caffè Superligë, ndërkohë Bora ishte finaliste e Ligës së Parë, ndërkohë që kishte fituar edhe Kupën e Ligës së Parë. Takimi zhvillohet të shtunën nga ora 20:30 në Therandë.

Kosova humbi ndeshjen e parë me Poloninë

Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll (femrat) ka pësuar humbje në ndeshjen e parë të fazës së dytë kualifikuese për Botërorin 2023. Në Bielsko-Biala, Polonia fitoi me rezultat 36:22. Në disa raste Kosova ka treguar lojë të mirë, por Polonia shfaqti më shumë. Përvoja dhe niveli se ku luajnë lojtaret e bëri dallimin. Të mërkurën "dardanet" i pret ndeshja e dytë në Prishtinë. Për Kosovën është hap i madh parakalimi në fazën e dytë kualifikuese. Në fazën e parë i ka kaluar Ishujt Faroe.

Trajneri i Clujit: E kam të vështirë ta mbaj Krasniqin në bankën rezervë

Trajneri i CFR Cluj, Dan Petrescu, ka folur fjalë të mira për sulmuesin anësor nga Kosova, Ermal Krasniqi, i cili ishte vendimtar në fitoren e së enjtes mbrëma ndaj Arges. CFR Cluj ka fituar minimalisht 1-0 ndaj Arges në çerekfinale të Kupës së Rumanisë, duke kaluar në gjysmëfinale. Goli i vetëm për gjigantin rumun erdhi në minutën e 89 dhe ishte malishevasi Ermal Krasniqi i cili ia siguroi Clujit kualifikimin. Krasniqi u inkuadrua në lojë në fillimin e pjesës së dytë dhe pasi ia siguroi fitoren. "Do të kisha dashur të kisha një lojtar para Krasniqit në fushë dhe ai të ishte rezervë. Ky do të ishte një grup me cilësi të lartë", ka thënë fillimisht Petrescu. "Krasniqi hyri edhe një herë me Arges dhe shënoi. E kam të vështirë ta mbaj në bankën rezervë", ka shtuar trajneri rumun.

MKRS-ja, memorandum bashkëpunimi me KOK-un dhe KPK-në

Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport (MKRS). Memorandumi parasheh mbështetje financiare për KOK-un për vitin 2023. Me këtë rast, presidenti i KOK-ut u prit nga zëvendësministrja Daulina Osmani, me të cilën biseduan për aktivitetet e vitit 2023, veçanërisht aktivitetet ndërkombëtare në të cilat ekipet e Kosovës do të marrin pjesë. Në takim ishte edhe presidentja e Komitetit Paralimpik të Kosovës, Njomza Emini, e cila, po ashtu, nënshkroi memorandum bashkëpunimi me MKRS-në.

Çeku: 30 federata sportive janë në prag të licencimit

PRISHTINË, 7 PRILL - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Hajrullah Çeku, në Kuvendin e Kosovës ka dhënë lajmin e madh për klubet e

Superligës së Kosovës. Ai ka thënë se afër 30 federata sportive janë në prag të licencimit, përfshirë këtu edhe Federatën e Futbollit të

Kosovës. "Jemi afër procesit të licencimeve. Mbi 30 federata janë në prag të licencimit", ka deklaruar Çeku. Kujtojmë që telenovela e licencimit të FFK-

së ka filluar që një kohë të gjatë, me klubet që deri tani kanë mbajtur rreth pesë takime për ta diskutuar punën e licencimit.



Në fundjavë duelet e dyta të "play-off"-it

PRISHTINË, 7 PRILL - Fundjava sjell ndeshjet e dyta të "play-off"-it në Prince Caffè Superligë. Ndeshja e parë është ndërmjet Vëllaznimit dhe Golden Eagle Yllit.

Kampioni e fitoi ndeshjen e parë 111:86 dhe është favorit për takimin e dytë, për të depërtuar në gjysmëfinale, ku e pret Peja, ndërsa vendasit do të përpiqen ta

barazojnë serinë në 1:1. Dueli Trepça - Bashkimi dëshmoi se takimet ndërmjet këtyre dy skuadrave janë gjithmonë interesante dhe kështu pritet edhe të dielën.

Takimin e parë e fituan mitrovicasit 92:88. Fituesi në gjysmëfinale ndeshet me Sigal Prishtinën. Skuadra që shënon dy fitore kualifikohet në gjysmëfinale.



Shumë klube e kërkojnë reprezentuesin e Kosovës, Toni Domgjoni

PRISHTINË, 7 PRILL - Toni Domgjoni me prejardhje nga Bishtazhina i Gjakovës, i lindur në Kroaci, momentalisht është pjesë e klubit holandez Vitesse. Ai ka marrë sinjale nga skaut të ndryshëm për të ndërruar ambient. Domgjoni është duke u kërkuar nga shumë klube gjermane të Bundesligës 2 dhe Bundesligës 1, përfshi Shtutgardin, Leverkusenin, Werder Bremenin, Mainz 05, Hamburgun, por edhe ekipet turke të Superligës si dhe Mallorcan spanjolle. Domgjoni gjatë karrierës së tij ka luajtur për klubin e qytetit të lindjes Slaven Belupo e më pas në Zurich dhe së fundmi në Vitesse. Pas paraqitjeve të shkëlqyeshme të tij, Domgjoni është ftuar nga kombëtarja zvicerane dhe ka luajtur në të gjitha kategoritë e reja të shtetit "helvetik". Pas paraqitjeve të mira Domgjoni ka rënë në sy edhe të kombëtares shqiptare si dhe të drejtuesve të Federatës së Futbollit të Kosovës. Domgjoni pasi ka marrë ftesën e shtetit ku i kanë lindur prindërit ai pa hezitim ka hequr dorë nga kombëtarja helveteke dhe, para se të pranonte



të luante për Shqipërinë, ai ka zgjedhur Kosovën në vitin 2021. Domgjoni ka tri paraqitje dhe ka shënuar një gol për përfaqësuesen e Kosovës. I pyetur nga "Epoka e re" se kënd e ka idol në futboll, Domgjoni është përgjigjur: "Unë e kam idol Ronaldon, por pozicioni im si mesfushor ofensiv nuk më

jep mundësi të arrij atë që e shoh te Ronaldo". Mesfushori shqiptar, Toni Domgjoni, është duke luajtur në ligën holandeze dhe ka një paraqitje të mirë edhe pse klubi nuk po gjënë rehatinë me stafin teknik. Vitesse për momentin është në vendin e 14-t të Eredivises Holandeze.

Denveri dorëzohet para Phoenixit, Miami fitore shprese ndaj Philadelphias

Phoenix, 7 prill - Humbja e dytë radhazi për Denverin, që gjithsesi ruan kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit. Denveri (Browni 31 pikë) u mund me rezultat 119-115 nga rivalët e Phoenixit. Për Suns-in u dalluan Duranti me 29 pikë e Pauli me 25. Fitore të rëndësishme për një vend në "play-off" korri Miami, që mundi me shifrat 129-101 Philadelphian jashtë fushës. Butleri



e Herro realizuan nga 24 pikë secili për Miamin, duke i bërë të pavlefshme 21 pikët e Embiidit për vendasit. Skuadra e Oklahomas, falë 22 pikëve të Shait, mposhti me rezultat 114-98 Utah Jazzin, ndërsa

Clevelandi triumfoi me rezultat 118-94 ndaj Orlandos, ndeshje ku u dallua Green me 21 pikë. Fitore për statistikë e San Antonios, që falë 25 pikëve të Diopit mundi me rezultat 129-127 Portlandin.

REZULTATET

Orlando - Cleveland	94-118
Philadelphia - Miami	101-129
San Antonio - Portland	129-127
Utah Jazz - Oklahoma	98-114
Phoenix - Denver	119-115

SHKURT

Ancelotti: Kurrë në jetë nuk do t'i bashkohesha Barcelonës

Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, ka folur në konferencë për medie para përballjes mjaft të vështirë ndaj Villarrealit. Trajneri italian u pyet edhe nëse do t'i bashkohej Barcelonës. "Kurrë në jetë nuk do t'i bashkohesha Barcelonës. E pamundur. Historia ime është këtu te Reali, klubi më i mirë në botë. Njerëzit më duan këtu", ka thënë Ancelotti, i cili është pjesë e Real Madridit që nga viti 2021, ndërkohë "Los Blancos" e kishte drejtuar edhe në periudhën 2013-2015.

Felixi, jashtë planeve të Atletico

Atletico Madridi ka filluar të bëjë plane për sezonin e ardhshëm dhe drejtuesit e klubit kanë bërë projektin me futbollistët që mund të bëhen pjesë e klubit, por këtu nuk bën pjesë rikthimi nga huazimi i Joao Felix. Klubi nga Madridi raportohet se është i interesuar ta shesë portugezin në Chelsea ose në ndonjë klub tjetër për t'i mbushur arkat e klubit. Synim mbetet shifra prej 100 milionë eurosh.

Russelli: Red Bulli ka shpejtësi edhe më të madhe, nuk e shfaq pasi ka frikë nga FIA

Ky sezon i Formulës 1 do të jetë tërësisht i Red Bullit, që i ka fituar të tri garat e zhvilluara deri më tani, duke shfaqur epërsi ndaj rivalëve. Madje duke llogaritur edhe vitin e kaluar, makina Red Bull ka fituar 13 nga 14 garat e fundit të Formulës 1 (Mercedesi fitoi në Brazil). Te Mercedesi kanë konfirmuar prej kohësh që Red Bulli do t'i fitojë të 23 garat sezonale, pasi janë të bindur për epërsinë që ata kanë. Madje piloti i ri britanik George Russell ka shkuar edhe më tej, duke thënë se rivalët nuk po shfaqin gjithë potencialin e tyre. Për BBC-në, Russelli shprehet: "Jam i sigurt se Red Bulli po fshihet. U vjen zor ta shfaqin gjithë potencialin e tyre. E dinë mirë se sa më shumë diferenca të kenë me ne dhe sa më të shpejtë të jenë aq më shumë FIA do të përpiqet t'i ndalojë në një mënyrë apo tjetër, me rregulla të reja". "Mendoj se ata janë shtatë të dhjetat më të shpejtë se në për xhiro. Nuk e mohoj se kanë bërë një punë të shkëlqyer dhe për këtë meritojnë të përgëzohen. Ndaj na duhet të përmirësohemi për të qenë si ata", u shpreh George Russell.

Cavani nuk mendon për pension

Sulmuesi Edinson Cavani ka thënë se nuk e ka ndër mend të tërhiqet nga futbollit, prandaj ka ardhur edhe në Klubin e Valencias. Klubi spanjoll po kalon çaste të vështira, por Cavani është i gatshëm të japë kontribut që ky klub ta sigurojë mbijetesën. "Po punoj dhe po përgatitem të jap gjithçka. Nuk erdha këtu për t'u tërhequr, por për të bërë një rrugëtim me këtë klub. Po dalim nga periudha e vështirë, por do të vazhdojmë të punojmë për t'i përmirësuar gjërat", ka thënë Cavani.

Katër trajnerë në listën e Chelseat

Pas shkarkimit të Graham Potter, Chelsea emëroi Frank Lampardin drejtues i përkohshëm, i cili do të qëndrojë me ekipin deri në

fund të sezonit. Për momentin, "blutët" janë në kërkim të një trajneri të përhershëm që do ta marrë drejtimin e skuadrës në verë. Sipas ESPN, ka katër

trajnerë yje në listën e Chelseas. Bëhet fjalë për Julian Nagelsmann, Luis Enrique, Mauricio Pochettino dhe Carlo Ancelotti. Vihet re se kjo nuk

është një listë e plotë e kandidatëve që do të konsiderohen nga londinezët. Kujtojmë se Luis Enrique u pa në Londër këtë javë. Në të

njëjtën kohë, trajneri spanjoll nuk iu përgjigj pyetjes, por vetëm qeshi me të. Chelsea aktualisht është në vendin e 11-të në renditjen e Premierligës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër: 304/1
Datë: 07.04.2023

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 Ligjit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, si dhe në bazë të kërkesës të dt. 30.03.2022 me nr. 1821 së QK "11 Marsi" në Prizren shpallë:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturanëve të QK "11 Marsi" në Prizren, në Republikën e Shqipërisë
Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjencionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarfë të mbyllur.

Agjencioni turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së.
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore,
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore,
- Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës,
- Autobusët të jenë komfort dhe me klimë,
- Agjencioni duhet të ketë deklaratë me shkrim se do të menjanoj shpejt prishjet eventuale të ndonjë autobusi ose zëvendësimin me autobus tjetër,
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit,
- Agjencioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës "D";
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënëseve;
- Agjencioni duhet të ketë një dëshmi për marrëveshje me hotelin ku mendon me i derguar nxënësit,
- KDSH e ka preferuar nisjen në periudhën 15 maj deri më 20 maj
- Agjencioni duhet të prezantojë dëshmi: menynë ditore të plotë për secilën ditë të ekskursionit.
- Agjencioni turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës
- Agjencioni duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE), se do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturo-historike.
- Agjencioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskursion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targat e autobusit që do të vozisin.

Kushtet tjera:

- Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimeve nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë,
- Pamvaresisht numrit të nxënëseve për paralele, kujdestarët e klasave shkojnë falas në ekskursion,
- Hoteli të posedojë sallë për ballo,
- Agjencioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike
- Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner),
- Mundësi vizite në qytetet: Tiranë, Durrësi i vjetër, Shkodër, Krujë, Berat, Vlorë etj.

Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e AAAPARr në Prishtinë.

Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi më i ulët ofertues
- Lloji i Hotelit (kategoria, nr. i nxënëseve nëpër dhoma etj)
- Menyja
- Numri i nxënëseve që udhëtojnë falas
- Gjendja teknike e autobusëve
- Referencat

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfutuesit do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje të shkollës.

Aplikuesit e interesuar Aplikacionet i marrin në shkollë.

Aplikuesit e interesuar ofertat e veta duhet t'i paraqesin në dy zarfë (në zarfën e vogël oferta e mbyllur e futur në zarfën e madhe e cila përmban dokumentacionet e kërkuara nga shkolla). Ofertat dorëzohen në zyret e AAAPARr në Prishtinë (Rruga „Agim Ramadani” p.n. nderta MASHT-i II, në katin e tretë, në objektin përball Fakultetit Ekonomik dhe Juridik në Prishtinë)

Data e nisjes mund të ndryshojë (mundësitë e datës së nisjes janë dhënë më lart tek parakushtet), ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

Afati i paraqitjes së ofertave është shtatë ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore.



Shoqata Humanitare 'Bëmtëria e Kosovës "Mëter Teresa"
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"
Humanitarne Dobrotvorne Udruzenje Kosova "Majka Teresa"
10-00 Prishtinë, Rr. ULPIANA 1/1 p.n. Tel: 00381 38 542 864, Fax: 542 865,
Web site: www.matherteresasociety.org e-mail: mteresa@yahoo.com

CONTRACT AWARD NOTICE

Supplies

According to Article 41 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 07/04/2023

Procurement No	Equipment	001	2023	121
----------------	-----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana UI/1		
Town: Prishtina	Postal code: 10000	Country: Kosovo
Contact point(s): Zef Shala		Telephone: 044-128-277
Email: zefshala@hotmail.com		Fax: 038-542-865
Internet address (if applicable):		www.matherteresasociety.org

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority:

Supplies with Bag Equipment for up to 350 Beneficiaries-Returnees

II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance

(Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)

<input checked="" type="checkbox"/> Supplies
Main place of performance All Kosovo according to the Request of Contracting Authorities

II.1.4) Short description of the object of the contract

Supplies with Bag Equipment for up to 350 Beneficiaries-Returnees

II.1.5) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)

93.000.000-8

II.1.6) Division into lots

YES

II.1.7) Contract value: 525,994.74 Euro

SECTION III: PROCEDURE

III.1) TYPE OF PROCEDURE

Open

III.2) AWARD CRITERIA

Lowest price

III.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

SECTION IV: AWARD OF CONTRACT

(In case of some parts given to some successful economic operators, repeat S IV.4 and IV.5 for each lot)

IV.1) Date of contract award 07/04/2023		
IV.2) Intended date of contract signing 18/04/2023		
IV.3) Number of received tenders 4		
IV.4) Name and addresses of economic operator to whom the contract has been awarded		
Official name: "General Supply and Logistics" Sh.p.k.		
Postal address: 10000 Prishtinë		
Town: Prishtinë	Postal code: 10000	Country: Kosovo
URL (if applicable):		
Contact point(s): Besfort Hyseni	Email: generalsupplyandlogistics@gmail.com	
Telephone: 045321797	Fax:	

IV.5) Information on value of contract

Total final value of contract 525,994.74 Euro

Responsive tender with lowest price: 525,994.74 Euro

Responsive tender with highest price: 585,080.26 Euro

IV.6) The contract is likely to be subcontracted

No

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract award notice.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 07.04.2023 bënë shpallje publike për dhënie e pronës së paluajtshme me qira.


Shpallje Publike

T-23-07

Qëllimi i ofertës:	Dhënie me qira e një pjese të repartit elektro-puntoria në njësisë biznesore Industria Kimike.
Kriteret e Dhënies:	Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë
Data e shpalljes:	07.04.2023
Sqarimi:	deri me 21.04.2023
Kërkesa për pjesëmarrje:	Data(t) për kërkesës deri: 21.04.2023 Behet ne e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e Divizioni i shitjes dhe qirasë.
Dorëzimi i ofertave:	Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur)
Afati i fundit i dorëzimit:	24.04.2023 në 11:00
Vendi i dorëzimit:	Divizioni i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A. Parku Industrial, Mitrovicë

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: Trepça sh.a.		
Adresa postare: Parku inustrial		
Qyteti: Mitrovicë	Kodi postarë: 40000	Shteti: Kosovë
Kontakti: Burim HAJDINI	Telefoni: +383 (0) 28 538 050	
Email: hajdini_b@hotmail.com	Faksi: +383 (0) 28 539 202	
www.trepçacorporation.com		



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Valdrin Sylaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. "Kadri Kusari" veterinar Gjakovë.

- Ideal Hasi Cermjan KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 të SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Florentin Gashi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.mu. "Ahmet RustemiBec nga kl. I-V dhe kl. VI-IX

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULË

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pulë



cilësi e garantuar

pa konservues